

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7929  
E mërkurë, 13 nëntor 2024  
Çmimi 0.50 €

## Buxhet për zhvillim a mbijetesë? | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## TRUMPI PRITET TA PËRZGJEDHË SENATORIN MARCO RUBIO NË POZITËN E SEKRETARIT TË SHITETIT | FAQE 4-5



Disa media amerikane kanë raportuar se Marco Rubio është në bisedime me ekipin e tranzicionit të presidentit të zgjedhur Donald Trump për pozitën e lartë, atë të

Sekretarit të Shtetit. Aktualisht ai shërben nënkryetar i Komitetit të Senatit për Inteligjencë dhe është anëtar i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë. Si

përfaqësues nga Florida në Senat, 53-vjeçari u zgjodh për herë të parë në vitin 2010. Përgjatë karrierës, rajonin e Ballkanit e kishte disa herë në fokus

**KRYETARJA E SPECIALES:  
PROKURORIA MUND TA  
PËRFUNDOJË RASTIN E  
KRERËVE TË UÇK-SË NË  
FILLIM TË PRILLIT 2025 | F. 5**



**POLICIA E  
KOSOVËS DHE  
AJO E SHQIPËRISË  
VAZHDOJNË  
BASHKËPUNIMIN | F. 4**



### AKTUALE



**KALLAS: DO TË PUNOJ QË ZGJERIMI  
I BE-SË TË BËHET REALITET | F. 2**

**LIDHJET E KOSOVËS ME VENDET  
FRANKOFONE JANË SHUMË  
MIQËSORE | F. 5**

**MURTEZAJ: KONTABILISTËT LUAJNË  
ROL KYÇ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK  
TË VENDIT | F. 6**

**POLITOLOGU ALBINOT MALOKU:  
GËRVALLA-SHWARZ, BURIM  
I VAZHDUESHËM SKANDALESH | F. 7**

### EKONOMI



**KUVENDI MIRATON NË LEXIM TË  
PARË BUXHETIN PËR VITIN 2025 | F. 8**

**FMN-JA VLERËSON LART REFORMAT  
NË BQK | F. 7**

### SPORT



**KRASNIQI DHE BYTYQI: PRESIM TA  
VAZHDOJMË SERINË E FITOREVE | F. 10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kallas: Do të punoj që zgjerimi i BE-së të bëhet realitet

**BRUKSEL, 12 NËNTOR** - Kandidatja për pozitën e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka thënë të martën, në një seancë dëgjimore, se do të angazhohet për ta forcuar sigurinë e bllokut evropian, dhe do të bashkëpunojë me fqinjët që ndajnë vlera të përbashkëta, si dhe kanë aspirata për anëtarësim në bllokun evropian.

Seanca dëgjimore është duke u zhvilluar në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, i cili duhet ta konfirmojë Kallasin për pozitën e nominuar. Kallas, ish-kryeministre e Estonisë, është caktuar nga shefja e BE-së, Ursula von der Leyen dhe vendet anëtare të bllokut, për ta udhëhequr politikën e jashtme në mandatin e ardhshëm pesëvjeçar.

Në legjislaturën e kaluar këtë pozitë e ka mbajtur Josep

Borrell.

Kallas ka thënë të martën se zgjerimi i BE-së e forcon vetë bllokun, por edhe vendet që synojnë anëtarësimin. Sipas Kallasit, forca tërheqëse e BE-së i frymëzon shtetet nga Ballkani Perëndimor e deri tek Evropa Lindore për reforma dhe për angazhim drejt integritit në BE. "Së bashku me Komisionaren për Zgjerim do të punoj me vullnet që ta bëjmë zgjerimin realitet", ka thënë ajo, duke shtuar se "problemet e sotme të fqinjëve tanë do të jenë probleme tona nesër".

Vendet e Ballkanit Perëndimor - përveç Kosovës - si dhe Ukraina, Moldavia, Gjeorgjia dhe Turqia janë kandidatë për anëtarësim në BE.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim, por aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende.

Kaja Kallas ka thënë se siguria e BE-së është e lidhur ngushtë me NATO-n dhe që do të



angazhohet për ta vazhduar bashkëpunimin transatlantik. Sipas saj, sfidat kryesore për BE-në dhe aleatët lidhen me

qasjen e Rusisë, Kinës, Iranit dhe Koresë së Veriut, vende, të cilat, sipas saj, janë duke e sfiduar rendin botëror.

Ajo e ka konsideruar me prioritet vazhdimin e ndihmës për Ukrainën dhe fitoren e Kievit e ka konsideruar të domosdoshme për Evropën.

Shefja e BE-së, Von der Leyen, veçse është konfirmuar.

Përgjatë ditës do të dëgjoen dëshmitë e katër kandidatëve që janë të propozuar për nënkryetarë ekzekutivë të Komisionit Evropian.

Deri më tash 20 kandidatë kanë përfunduar seancat dëgjimore dhe të gjithë, përpos kandidatit nga Hungaria, Oliver Varhelyi, kanë marrë mbështetjen.

Më vonë gjatë ditës, komisioni përkatës pritet të vendosë edhe për Varhelyin.

Nëse të gjithë kandidatët marrin mbështetjen e komisioneve parlamentare, atëherë më 24 ose 25 nëntor Parlamenti Evropian duhet ta konfirmojë Komisionin e ri Evropian. Në atë rast, Komisioni do ta nisë mandatin më 1 dhjetor të këtij viti.

## Gjermania pritet t'i mbajë zgjedhjet e parakohshme më 23 shkurt



Berlin, 12 nëntor - Gjermania pritet t'i mbajë zgjedhjet e parakohshme më 23 shkurt, njëmbëdhjetë javë pas prishjes së koalicionit qeveritar, dhe burimet thonë se Social-Demokratët, Të Gjelbrit dhe konservatorët kanë arritur kompromis për kohën.

Partitë opozitare dëshirojnë të ketë zgjedhje qysh në janar, dhe kanë paralajmëruar se Gjermania rrezikon të mbetet pa timon në kohën e krizës ekonomike, dhe në kohën kur fitorja e Donald Trumpit në Shtetet e Bashkuara përbën sfida të reja diplomatike.

Mirëpo, Scholz ka paralajmëruar se zgjedhjet në janar mund ta ngarkojnë autoritetin zgjedhor në kohë pushimesh dhe që partitë mund të përfundojnë të papërgatitura.

Për t'i organizuar zgjedhjet e reja, Scholz duhet të thërrasë votëbesim dhe ta humbasë atë në Parlament.

Koha e mbajtjes së një seance të tillë nuk dihet, mirëpo mediet lokale kanë raportuar se do të mund të organizohet në mesin e dhjetorit.

Scholz, i cili aktualisht udhëheq një qeveri të pakicës, me

përkrahjen e të Gjellbërve, shpreson të sigurojë mjaftueshëm mbështetje për t'i miratuar ligjet për mbrojtje të Gjykatës Kushtetuese nga e djathta ekstreme, dhe për të ndarë fonde për Ukrainën para se të largohet nga zyra e kryeministrit.

Qeveria e tij është rrëzuar pas disa muajsh të mospajtimeve mes partive në pushtet, dhe gjithçka ka përfunduar kur neoliberalët, Demokratët e Lirë, kanë kërkuar shkurtime buxhetore, për të cilat nuk kanë mundur të pajtohen partnerët e krahut të majtë.

## Trumpi zgjedh Elise Stefanik ambasadore në OKB

**WASHINGTON, 12 NËNTOR** - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka zgjedhur Elise Stefanik, për të shërbyer ambasadore në Kombet e Bashkuara. "Elise është një luftëtare e fortë dhe e mençur e Amerika e Para", tha Trump një ditë më parë.

Stefanik, 40-vjeçare, është një nga aleatët më besnikë të Trumpit në Dhomën e Përfaqësuesve dhe ishte një nga emrat që ishte diskutuar për kandidatë për nënpresidentë.

E lindur dhe e rritur në Nju-Jork, Stefanik ka diplomuar në Harvard dhe ka punuar në Shtëpinë e Bardhë në kohën kur president ishte republikani George W. Bush. Në administratën e Bushit ajo kishte punuar në këshillin për politika të brendshme dhe ishte shefe e stafit.

Më 2014, si 30-vjeçare ajo u bë gruaja më e re e zgjedhur ndonjëherë në Kongres, duke përfaqësuar Nju-Jorkun. Më vonë ajo u bë gruaja më e re në udhëheqjen e Dhomës së

Përfaqësuesve.

Më herët Stefanik njihej si një konservatore më e moderuar, por më pas ajo u afrua me Trumpin. Për vite të tëra ajo e ka pozicionuar veten si një prej aleatëve më besnikë të Trumpit në Kongres. Ajo e përkrahu atë për garën presidenciale të vitit 2024, edhe para se Trumpi ta niste fushatën. Ajo e ka mbrojtur presidentin e zgjedhur gjatë gjykimeve për shkarkim, po ashtu ka kundërshtuar paditë penale kundër tij.



## OVLUÇK-ja ndan dekoratë për Liman Musliun

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka ndarë dekoratë për ish-luftëtarin e UÇK-së, Liman Musliu, i cili tragjikisht ka ndërruar jetë të shtunën. Dekorata për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare dhe vetëmohimin e jashtëzakonshëm në luftën e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është dorëzuar nga ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku. Ky i fundit dekoratën ia ka dorëzuar djalit të të ndjerit. "Veteranët e Luftës së UÇK-së, Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët nga e gjithë Kosova i shprehën ngushëllime

familjarëve e miqve të të ndjerit Liman Musliu, të cilit OVLUÇK i ndau dekoratë për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare dhe vetëmohimin e jashtëzakonshëm në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës tij!", ka shkruar Klinaku në "Facebook".



## Policia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë vazhdojnë bashkëpunimin

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, i shoqëruar nga stafi i lartë i tij, ka pritur të martën në takim miqësor drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shqipërisë, Ilir Proda, po ashtu i shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë policorë të shtetit.

Në takim, i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, drejtori Hoxha fillimisht ka falënderuar drejtorin Proda për vizitën e tij dhe njëkohësisht ia ka uruar detyrën në krye të Policisë së Shtetit.

Drejtori Hoxha i njoftoi të pranishmit mbi angazhimet, aktivitetet dhe objektivat e Policisë së Kosovës, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm për përbushjen e detyrave dhe obligimeve të saj ligjore në të mirë të



sigurisë dhe rendit kushtetues në Republikën e Kosovës.

Përveç të tjerash, të pranishmit u njoftuan se Policia e Kosovës ka

kapacitete profesionale dhe është e përgatitur të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar si dhe të bashkëpunojë ngushtë me

organizatat policore, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe parandalimit të

terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Gjithashtu, është veçuar se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të shkëlqyer me autoritetet policore të Shqipërisë, bashkëpunim ky i cili ka treguar rezultate pozitive në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe sukseset në patrullimet e përbashkëta policore dhe luftën ndaj dukurive negative.

Në anën tjetër, drejtori Proda falënderoi drejtorin Hoxha për mikpritjen dhe, njëherësh, potencoi se Policia e Shqipërisë do të jetë çdoherë e gatshme për realizimin e synimeve të të dy policive si në fushën e trajnimeve, po ashtu edhe të luftës ndaj krimit, përfshirë atë transkufitar. Takimi u përfundoi me zotimin e dy përfaqësuesve kryesorë të dy institucioneve simotra, për rritje të mëtejshme të bashkëpunimit në të ardhmen, duke u zgjeruar edhe në fusha të reja me interes të përbashkët.

## KQZ-ja anëtarësohet në Rrjetin e Institucioneve Zgjedhore Frankofone

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se është pranuar njëzëri anëtarësi në rrjetin e Institucioneve Zgjedhore Frankofone (RECEF).

Vendimi i RECEF është marrë më 25 tetor 2024 në Asambleshën e Përgjithshme që është mbajtur në Cotonu, Benin.

Lidhur me këtë vendim është njoftuar kryesuesi i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, nëpërmjet një letre të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i RECEF, Jean - François Blanchet.

Në këtë letër të dërguar nga Blanchet theksohet: "Jemi të kënaqur t'ju informojmë se Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) i Republikës së Kosovës është pranuar njëzëri gjatë asamblesë së fundit të përgjithshme të RECEF".

Rrjeti i Institucioneve Zgjedhore



Frankofone (RECEF) është një grup ndërkombëtar i administratorëve

zgjedhorë në botën frankofone, që promovon zhvillimin e rregullt të

zgjedhjeve të lira, të besueshme dhe transparente.

Për të arritur këtë qëllim, RECEF ndërmerr veprime të ndryshme, përfshirë: mbështetjen për anëtarët e tij në profesionalizimin dhe krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura; nxitje të profesionalizimit përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira; si dhe promovon pjesëmarrjen e plotë të qytetarëve në ngjarjet zgjedhore.

Kryesuesi i KQZ-së, Radoniqi, pas pranimit të njoftimit, ka falënderuar Blanchet për vendimin e RECEF, duke e vlerësuar këtë si një hap të rëndësishëm për ta promovuar demokracinë dhe për të kontribuar në proceset zgjedhore. "Ne zotohemi se do të japim kontributin tonë në RECEF për t'i shërbyer me seriozitet të lartë misionit për zgjedhje të lira, të besueshme dhe transparente", thuhet në letrën e falënderimit të KQZ-së.

## Begaj: Institucionet shqiptare janë në mbështetje të plotë të çështjes së shqiptarëve të Luginës

Prishtinë, 12 nëntor - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka takuar deputetin e Luginës së Preshevës në Serbi, Shaip

Kamberin. Ai ka bërë me dije se me Kamberin kanë diskutuar për shqetësimet me të cilat përballen shqiptarët në

këtë trevë. "E sigurova se Presidenti i Republikës së Shqipërisë, qeveria dhe institucionet shqiptare janë në

mbështetje të plotë të çështjes së shqiptarëve të Luginës së Preshevës", ka shkruar Begaj në "Facebook".





## Trumpi pritet ta përzgjedhë senatorin Marco Rubio në pozitën e Sekretarit të Shtetit

Disa media amerikane kanë raportuar se Marco Rubio është në bisedime me ekipin e tranzicionit të presidentit të zgjedhur Donald Trump për pozitën e lartë, atë të Sekretarit të Shtetit. Aktualisht ai shërben nënkryetar i Komitetit të Senatit për Inteligjencë dhe është anëtar i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë. Si përfaqësues nga Florida në Senat, 53-vjeçari u zgjodh për herë të parë në vitin 2010. Përgjatë karrierës, rajonin e Ballkanit e kishte disa herë në fokus

WASHINGTON, 12 NËNTOR - Donald Trumpi pritet ta zgjedhë senatorin Marco Rubio në pozitën e Sekretarit të Shtetit, sipas disa burimeve të cituara nga disa media amerikane. Nëse kjo konfirmohet, atëherë politikani nga Florida do të jetë hispaniku i parë që do të shërbejë si kryediplomat amerikan, sapo presidenti i zgjedhur republikan ta marrë detyrën në janar. Senatori Rubio momentalisht shërben nënkryetar i Komisionit të Senatit për Zbulimin. Ai, gjithashtu, është anëtar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë. Sipas burimeve të cituara nga disa media, Trumpi ka zgjedhur ligjvënësin republikan Mike Waltz për pozitën e Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare. Waltz njihet për qëndrimet e tij të ashpra ndaj Kinës. Një tjetër vendim për kabinetin e presidentit të zgjedhur Donald Trump, sipas dy burimeve të rrjetit CNN, është përzgjedhja e guvernatores së Dakotës së Veriut Kristi Noem për pozitën e

sekretares së Departamentit të Sigurisë Kombëtare. Ashtu si edhe senatori Rubio, guvernatorja Noem ishte përmendur si kandidate e mundshme e Trumpit për pozitën e nënpresidentes gjatë fushatës zgjedhore. Ajo momentalisht është në mandatin e saj të dytë si guvernatore pas një fitoreje bindëse në vitin 2022. Ndërkaq, nga lista e ngushtë e kandidatëve të Trumpit për sekretar Shteti, senatori Rubio është politikani që ka folur më hapur për një politikë të jashtme më të ashpër ndaj kundërshtarëve gjeopolitikë të Amerikës, përfshirë Kinën, Iranin dhe Kubën. Gjatë viteve të fundit ai ka zburur disa nga qëndrimet e tij për t'iu përshtatur atyre të Trumpit. Presidenti i zgjedhur i akuzon presidentët e kaluar të Shteteve të Bashkuara se e kanë angazhuar Amerikën në luftëra të kushtueshme dhe të panevojshme dhe ka folur në mbështetje të një politike të

jashtme më të përbajtur. Ndërsa Trumpi njihet për qëndrimet e tij të paparashikueshme dhe si një person që mund ta ndryshojë mendjen edhe në minutën e fundit, deri të hënën ai dukej se ishte i vendosur në zgjedhjen e Rubios për sekretar Shteti, sipas burimeve, të cilët folën në kushte anonimiteti për disa media. Përfaqësuesit e Trumpit dhe senatorit Rubio nuk iu përgjigjën menjëherë kërkesave për koment. Administrata e re do të përballet me një botë më të paqëndrueshme dhe më të rrezikshme sesa ishte kur Trumpi mori detyrën në vitin 2017. Luftërat në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme po vazhdojnë, ndërsa Kina vazhdon të lidhet më ngushtë me armiqtë e Uashingtonit, Rusinë dhe Iranin. Kriza e Ukrainës do të jetë pika kryesore në programin e Sekretarit të ardhshëm të Shtetit. 53-vjeçari Rubio ka thënë në intervistat e fundit se Ukraina duhet të kërkojë një zgjidhje të negociuar me Rusinë në vend që të përqendrohet në rimarrjen e të gjithë territorit që Rusia e ka pushtuar në dekadën e fundit. Ai ishte, gjithashtu, një nga 15 senatorët republikanë që votuan kundër një pakete ndihmash ushtarake prej 95 miliardë dollarësh për Ukrainën, të miratuar në muajin prill. Ndërsa senatori Rubio është kandidati që ka folur më shpesh për politika më të ashpra të jashtme, zgjedhja e tij e mundshme nënvizon një ndryshim të rëndësishëm në pikëpamjet e politikës së jashtme

republikane të Trumpit. Dikur partia e zyrtarëve që flisnin më shumë në favor të ndërhyrjeve ushtarake dhe një politike të jashtme që tregon muskujt, shumica e aleatëve të Trumpit tani flasin për përbajtje, veçanërisht në Evropë. Shumë republikanë ankohen që aleatët e Amerikës në Evropë nuk po investojnë sa duhet në mbrojtjen e tyre. "Unë nuk jam në anën e Rusisë por, fatkeqësisht, realiteti është se mënyra se si do të përfundojë lufta në Ukrainë është me një zgjidhje të negociuar", kishte thënë senatori Rubio për rrjetin NBC në muajin shtator. Përzgjedhja e Rubios ka rëndësi brenda Shteteve të Bashkuara dhe në arenën ndërkombëtare. Kandidati republikan Trump mundi nënpresidenten demokrate Kamala Harris në zgjedhjet e 5 nëntorit pjesërisht duke rritur mbështetjen në mesin e votuesve latino-amerikanë, të cilët kishin votuar me shumicë për demokratët në ciklet e mëparshme zgjedhore. Ky grup votuesish, megjithatë, është bërë një grup demografik gjithnjë e më i larmishëm në kuptimin politik, me gjithnjë e më shumë latino-amerikanë që votojnë republikanët. Duke zgjedhur senatorin Rubio për një rol kyç në politikë, presidenti i zgjedhur Trump mund të vazhdojë ta konsolidojë mbështetjen në mesin e hispanikëve dhe të bëjë të qartë se ata kanë një vend në nivelet më të larta të administratës së tij. Nëse konfirmohet, senatori Rubio ka të ngjarë t'i kushtojë një

rëndësi shumë më të madhe Amerikës Latine se çdo sekretar i mëparshëm i shtetit, tha Mauricio Claver-Carone, një aleat i tij dhe ish-president i Bankës Ndër-Amerikane për Zhvillim. "Kjo është koha kur Amerika Latine do ta ketë vëmendjen më të madhe në historinë e çdo president të Shteteve të Bashkuara. Është me rëndësi historike", tha Claver-Carone. Në vitin 2021, Rubio mirëpriti lajmin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Izraelit dhe Kosovës. "Ky është një hap i rëndësishëm për të dyja vendet si dhe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare", shkroi Rubio në X. Vitin e kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë një vizite në Uashington, u prit nga një grup senatorësh dhe kongresistësh amerikanë, në mesin e të cilëve ishte edhe Rubio. Në atë takim, Osmani vlerësoi "kontributin e jashtëzakonshëm që Kongresi ka dhënë në forcimin e pozitës ndërkombëtare" të Kosovës. Në vitin 2018 me Rubion u takua edhe presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi. "Folëm për mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dypalësh, për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për mundësitë euroatlantike të Kosovës dhe për shfrytëzimin e momentumit për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila siguron anëtarësimin e Kosovës në NATO, BE dhe OKB", tha atëkohë Thaçi.

# Lidhjet e Kosovës me vendet frankofone janë shumë miqësore

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Në sallën e Kuvendit të Kosovës të martën filluan punimet e sesionit të 36 Asamblesë Rajonale të Evropës (ARE) të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, në të cilat mori pjesë kryeministri Albin Kurti si folës kyç.

Nga viti 2022 Kuvendi i Kosovës ka statusin e anëtarit të asociuar në Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë. “Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës kam kënaqësinë t’ju mirëpres e t’ju bashkoem këtu në tempullin e demokracisë sonë. Në vendin tim, si në tuajin, parlamenti simbolizon luftën tonë të përbashkët për të mbrojtur parimet që burojnë nga modeli më i mirë i shoqërisë që ka ekzistuar ndonjëherë, pra demokracia. Por, më shumë se kaq, në Kosovë ky parlament simbolizon një përpjekje të gjatë për liri, drejtësi dhe barazi. Mund të tingëllojë e çuditshme të dëgjoni se sot jemi vetëm një çerekshekulli nga çlirimi i Kosovës dhe më pak se 17 vjet nga pavarësia e vendit tonë. Andaj, duke ju drejtuar këtu, ku shumica prej nesh kanë ende një kujtim të freskët të viteve të errëta të fundshekullit të XX-të, dëshiroj të theksoj se demokracia, të drejtat themelore të njeriut dhe paqja, nga të cilat ne të gjithë ishim të privuar në atë kohë, kanë sot një kuptim shumë të çmuar për neve”, ka thënë Kurti, duke shtuar se ndër këto vlera fundamentale, edhe pse popullsia e Kosovës është rreth 93 % shqiptare, “vendi ynë jetëson një shkallë të lartë respekti për shumëgjihësinë dhe multikulturalizmin, e cila është e ngërthyer në Kushtetutën tonë dhe vërehet në çdo ligj shtetëror, ndërsa 20 nga 120 ulëse në Kuvend janë të rezervuara për pakicat etnike. Rrjedhimisht, Kosova është një vend ku mund të gjenden vlerat

rrënjësore që i ndajmë me botën e frankofonisë. Megjithatë, më duhet të vë në pah se, përkundër dëshirës për t’u avancuar nga anëtare e asociuar në anëtare të plotë të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, Kosova ende nuk ka mundur t’i përmbushë të gjitha detyrat e nevojshme për të fituar këtë status. Samiti i fundit i mbajtur në Francë tetorin e kaluar, dhjetë vjet pasi Kosova u bë anëtare vëzhguese, ishte gjithsesi një moment i rëndësishëm në rrugën tonë drejt vlerave përbërëse të organizatës”, ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se është i bindur se potenciali i plotë i zhvillimit të mësimin të frëngjishtes në Kosovë mbetet ende i pashfrytëzuar. “Prandaj, në pritje të samitit të ardhshëm të vitit 2026, kur Kosova synon të aplikojë sërish për marrjen e statusit të anëtarit me të drejta të plota, Qeveria jonë dhe komunat e Kosovës duhet të fillojnë të punojnë së bashku për të gjetur një mënyrë për të adresuar rënien e orëve të mësimin të gjuhës frënge në mbarë vendin. Ky duhet të jetë hapi i parë duke e ditur që mund të llogarisim në përkrahjen e Institutit francez të Kosovës të porsaformuar në Prishtinë, për të identifikuar së bashku mënyrat më praktike dhe efektive të suksesit”, ka deklaruar Kurti.

Duke iu drejtuar të ftuarve të Asamblesë Parlamentare Frankofone, Kurti ka thënë se ambicia e Kosovës për t’iu bashkuar plotësisht Organizatës Ndërkombëtare Frankofone shkon përtej perspektivës së vetme dhe unike të mësimin të frëngjishtes në vetvete. “Krahas mjetit të jashtëzakonshëm të emancipimit dhe qasjes që ofron gjuha franceze, këtë të fundit e shoh si një faktor që përshpejton bashkëpunimin ndërmjet vendeve, sipërmarrësve dhe zhvillimin e Kosovës”, ka thënë Kurti. Ndërkaq kryetari i Kuvendit,



Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim delegacionin e Asamblesë Rajonale të Evropës të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, në krye me senatorin e Belgjikës, Anne Lambelin. Në këtë takim u diskutua rreth aspektit kulturor dhe vleror, të cilin vendi ynë e ndan së bashku me Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë dhe vendet anëtare.

Kryetari Konjufca tha se është e rëndësishme ta rrisim gjithnjë e më shumë shkallën e bashkëpunimit mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe APF-së, e në këtë drejtim ai shtoi se institucionet e vendit janë të gatshme të angazhohen për më shumë shtirrje të gjuhës dhe kulturës frënge, për ta mundësuar sa më shumë mësimin dhe studimin e tyre në vendin tonë, duke konsideruar trashëgiminë e pasur dhe kontributet që ato ofrojnë.

Mysafirët e falënderuan kryetarin Konjufca për pritjen dhe u shprehën të kënaqur që gjenden në Kosovë e në këtë mënyrë bëhet një hap më tutje në drejtim të bashkëpunimit të ngushtë, shkëmbimit kulturor dhe gjuhësor.

Kryekuvendari Konjufca theksoi faktin se përmes Kuvendit të Kosovës vendi ynë është pjesë e APF-së, e kjo tregon edhe se lidhjet e Kosovës me vendet frankofone janë evidente dhe shumë miqësore. Në të njëjtën kohë, ai tha se kjo është mundësi për angazhim diplomatik dhe mbrojtje të vlerave të përbashkëta.

Pas takimit, kryetari Konjufca së bashku me mysafirët morën pjesë në sesionin e 36-të Asamblesë Rajonale të APF-së që u mbajt në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe që është i pari i mbajtur në Kosovë. “Republika e Kosovës e vlerëson dhe mburret me praninë dhe angazhimin e saj aktiv në APF, një forum ky politik që në thelb të misionit të tij e ka promovimin e bashkëpunimit mes vendeve frankofone, forcimin e kapaciteteve të parlamentarëve dhe promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në të gjithë botën frankofone dhe përtej kësaj”, tha kryetari Konjufca në fjalën e tij hapëse të këtij sesioni të Asamblesë Rajonale të APF-së.

Ai tha se kultura e pasur frankofone ka qenë dhe mbetet

inspirim për mbarë botën, me ndikimin e saj shumëdimensional, përfshirë edhe ndikimin e saj te studiues dhe intelektualë Rilindas shqiptarë, e më pas me ndikimin që ata patën në përhapjen e kulturës dhe gjuhës frënge midis brezave të rinj shqiptarë.

Kryetari Konjufca shfrytëzoi nga rasti që të falënderojë të pranishmit që janë pjesë e delegacionit të APF-së, për mbështetjen që i kanë dhënë amandamentit të propozuar nga delegacioni i Kosovës dhe kaluar, me anë të të cilit dënohej sulmi terrorist në veriun e Kosovës, që ndodhi në shtator të vitit të kaluar, që synonte destabilizimin, kërcënimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit tonë. “Dua t’ju shpreh mirënjohjen time më të përzemërt juve si Asamble Rajonale e APF-së, për përpjekjet dhe angazhimin e palëkundur për promovimin e vlerave tona të përbashkëta dhe nxitjen e bashkëpunimit kulturor midis shteteve anëtare të frankofonisë”, tha në fund kryetari Konjufca, duke iu uruar pjesëmarrësve punime të mbara në këtë sesion.

## Kryetarja e Speciales: Prokuroria mund ta përfundojë rastin e krerëve të UÇK-së në fillim të prillit 2025

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekatarina Trendafilova, duke folur në lidhje me rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, ka thënë se kjo çështje mund të përfundojë në prill të vitit 2025. “Është një rast voluminoz. Kemi dhjetë akuza për secilin të akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. 153 viktima të përkatësive të ndryshme etnike, shqiptarë, serbë, romë, egjiptianë. Prandaj kemi etni të ndryshme të njerëzve. Dua të sqaroj për të gjithë që janë të interesuar, nuk



duhet të mendoni se gjyqtarët po ua japin të gjithëve statusin pjesëmarrës, ua japin statusin

e viktimave të supozuara, dhe kemi kritere të ashpra që duhet të përmbushen në mënyrë që

dikush të jetë në gjendje të marrë pjesë në procedura si dëshmitar”, ka thënë ajo. Trendafilova ka bërë me dije se prokuroria ka edhe 43 dëshmitarë për t’i dëgjuar në rastin e liderëve të UÇK-së. “I kam detyrat e mia jo vetëm të presidentes, por edhe gjyqtares. Ajo që më është komunikuar nga Prokuroria është se janë 43 dëshmitarë dhe data e fundit është më 8 prill për t’i dëgjuar. Javën e kaluar Prokuroria vendosi për t’i larguar 14 dëshmitarë. Kjo është politikë e fortë që është kryer në një sërë konferencash me palët. Numri fillestar i

dëshmitarëve ishte 152, e pastaj Prokuroria tha se mund të shtojë të tjerë me numër të përgjithshëm 350. Kjo është një prej të dhënave që është marrë për efikasitetin në këtë rastin në fillim të prillit, ndoshta edhe më herët”, ka thënë Trendafilova.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ndodhen në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023.

## Murtezaj: Kontabilistët luajnë rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit

Prishtinë, 12 nëntor - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ishte pjesëmarrës në organizimin e mbajtur të martën me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve nga Instituti AAB me temën "Transformimi digjital në fushën e kontabilitetit dhe auditimit".

Në fjalën e tij, ndër të tjera, ai tha se kontabilistët luajnë rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit. "Përmes analizës, planifikimit dhe zbatimit të praktikave më të mira, kontabilistët i ndihmojnë

organizatat dhe individët ta rrisin efikasitetin, t'i ruajnë kursimet dhe t'i shmangin reziqet financiare. Një ndër organizatat që është e ndërlidhur shumë me qasjen dhe profesionalizmin e kontabilistëve është pikërisht Administrata Tatimore e Kosovës", ka thënë ai.

Murtezaj ka thënë se digjitalizimi sikurse në shumë fusha të tjera, edhe në profesionin e kontabilistit dhe në sistemin tatimor ka imponuar nevojën për ndryshim të praktikave të punës. "Pra, kur kthehem vite

më parë, atëherë besoj që të gjithë pajtohemi se sa proces i vështirë ka qenë procesi i deklarimit dhe pagesës së tatimeve. Sot jemi dëshmitarë të një revolucioni të ndodhur në sistemin tatimor. Pra, kemi një sistem online të deklarimit dhe pagesës së tatimeve 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Kemi një sistem që ofron pothuajse 100 % shërbime online për bizneset dhe qytetarët, pa pasur nevojë që përfaqësuesit e bizneseve dhe qytetarët t'i vizitojnë fizikisht zyrat e ATK-së", ka deklaruar Murtezaj.



## Blonden: Belgjika do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën në procesin e integritetit evropian



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit për Integritet Evropian, Fjolla Ujkani, e shoqëruar nga deputetja Time Kadrijaj, anëtare e këtij komisioni, priten të martën në takim senatorin belg Vincent Blonden, me të cilin diskutuan për raportet ndërparlamentare si dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Gjatë takimit, i cili u zhvillua në frymën e një bashkëpunimi shumë miqësor, zëvendëskryetarja e komisionit, Ujkani, e falënderoi Blonden për përkrahjen e vazhdueshme që Belgjika po i jep Kosovës, dhe e

njoftoi për punën dhe sfidat e Komisionit për Integritet Evropian.

Duke folur për angazhimet dhe objektivat shtetërore të Kosovës, zëvendëskryetarja Ujkani u shpreh se Kosova nuk ka rrugë tjetër përpos anëtarësimit në KIE, BE e në NATO andaj, sipas saj, përkushtimi ynë i përditshëm është që kjo të arrihet sa më parë.

Për arritjen dhe përmbushjen në tërësi të këtyre aspiratave, Ujkani kërkoi që shteti belg të jetë edhe më tej mbështetës i qëllimeve shtetërore të Kosovës. Ndërkaq deputetja Time

Kadrijaj, pasi e falënderoi Blonden dhe shtetin që ai përfaqëson për mbështetjen e gjertanishme, po ashtu nënvizoi se, për arritjen e qëllimeve politike që ka vendi ynë, përfaqësuesit e Kosovës janë dhe do të mbeten përherë të unifikuar.

Senatori Blonden ndërkaq tha se Belgjika do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën në procesin e integritetit evropian dhe vlerësoi, po ashtu, se edhe ky takim është në kuadër të një informimi më gjithëpërfshirës lidhur me aspiratat e shtetit të Kosovës.

## Daut Haradinaj mbështet Ramush Ahmetajn në garën për deputet: Ishte luftëtar i dalluar

DEÇAN, 12 NËNTOR - Anëtari i Kryesisë së AAK-së, Daut Haradinaj, në "Facebook" ka bërë me dije se bashkë me Sheh Tekijën ishin për drekë në konakun e Ramush Ahmetajt në Belle.

Ahmetaj është kandidat për deputet në listën e AAK-së në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Daut Haradinaj tha se djemtë e Smajl Ahmetajt prej vitësh po dëshmojnë përkushtim për rritjen e turizmit malor nëpërmes investimit super të qëlluar në gastronomi dhe hotelieri.

Haradinaj i ka ofruar mbështetje ish-luftëtarit të UÇK-së dhe biznesmenit Ramush Ahmetajt në garën për deputet. "Pata kënaqësinë që të drekojmë bashkë me Sheh Tekijën në konakun e Ramush Ahmetajt në Belle. Djemtë e Smajl Ahmetajt



prej vitësh po dëshmojnë përkushtim për rritjen e turizmit malor nëpërmes investimit

super të qëlluar në gastronomi dhe hotelieri. Në këtë konak bashkë me shehun e nderuar,

biseduam për shumë tema, ku njëzëri i dhamë mbështetje në garën për deputet luftëtarit të

dalluar të orëve të para, Ramush Smajl Ahmetaj", ka shkruar Daut Haradinaj.

## Kurti shkoi për ngushëllime në familjen Musliu

Drenas, 12 nëntor - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe deputetë të Kuvendit, kanë shkuar sot për ngushëllime në familjen Musliu në Drenas. Ai u

shprehu familjarëve dhe miqve ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e më të dashurit të tyre, Liman Musliu, të cilin tha se do ta kujtojmë gjithmonë për kontributin kombëtar dhe shërbimin ndaj vendit dhe

Forcës së Sigurisë së Kosovës. I ndjeri Liman Musliu ishte pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe zyrtar civil në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së.



## Uji i liqenit të Badovcit mund të përdoret për pije

Prishtinë, 12 nëntor - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka bërë me dije se qytetarët që furnizohen me ujë nga Liqeni i Badovcit mund ta përdorin atë për pije pas rënies së niveleve të manganit.

Qytetarët e rajonit të Prishtinës që janë furnizuar me ujë të këtij liqeni nuk kanë mundur të përdorin ujin për pije dhe as për gatim që prej 4 tetorit. "Informatë rreth manganit në ujin e Ujësllësit Rajonal KRU

'Prishtina' që vjen nga Liqeni i Badovcit. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka vazhduar monitorimin e ujit për pije të Ujësllësit Rajonal KRU 'Prishtina' që vjen nga Liqeni i Badovcit. Rezultatet nga analizat e katër ditëve të fundit (e premte, e shtunë, e diele dhe e hënë, 8-12 nëntor) tregojnë se vlerat e manganit kanë zbritur dhe ato rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin e pijes.

Bazuar në këto rezultate, uji mund të përdoret edhe për pije. IKShPK i ka rekomanduar KRU 'Prishtina' që të vazhdojë mbikëqyrjen dhe trajtimin e ujit dhe të sigurojë ujë në sasi dhe cilësi, sipas standardeve për ujin e pijes. IKShPK falënderon qytetarët për mirëkuptimin e shprehur gjatë periudhës sa uji nuk mund të përdorej për pije dhe i siguron ata se do të vazhdojë me monitorim të rregullt dhe përcjellje të cilësisë së ujit", ka njoftuar IKShPK-ja.



## FMN-ja vlerëson lart reformat në BQK

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka marrë vlerësim të lartë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pas përfundimit të suksesshëm të rishikimit të tretë Marrëveshjeve Stand-By Arrangement (SBA), Resilience and Sustainability Facility (RSF) dhe konsultimet për Artikullin IV gjatë qëndrimit të Misionit të FMN-së në vendin tonë nga data 28 tetor deri më 11 nëntor.

FMN-ja ka theksuar përkushtimin e BQK-së për reformën ambicioze institucionale, duke përfshirë përmirësimin e qeverisjes dhe strukturës institucionale të saj. Vlerësimi pozitiv i FMN-së

nënvizon qasjen proaktive të BQK-së për ta forcuar qeverisjen, stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë si dhe reformat e ndërmarra drejt harmonizimit me standardet dhe praktikën e zbatuara në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, FMN ka vlerësuar progresin e BQK-së për avancimin e kornizës ligjore përmes Ligjit të ri për Bankat dhe Ligjit për Shërbimet e pagesave, që aktualisht janë në shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat, përveçse do ta forcojnë dhe avancojnë mbikëqyrjen bankare, do ta mbështesin integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Sa i përket sektorit financiar, ekipi i FMN-së konstaton se

sektori bankar mbetet i qëndrueshëm dhe në rritje mbështetur nga kreditimi i fortë dhe i qëndrueshëm, likuid dhe i kapitalizuar në nivele adekuate dhe me normë të ulët të kredive joperformuese. Reformat e ndërmarra nga BQK-ja janë për ta kapitalizuar sektorin duke zbatuar shtesat kundërciklike të kapitalit dhe shtesat e kapitalit për bankat sistemike. FMN-ja vlerëson progresin dhe hapat e ndërmarrë nga BQK për ta integruar Kosovën në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA) përmes avancimit të kornizës ligjore dhe dorëzimit të paraaplikimit të DG FISMA i Komisionit Evropian dhe Këshillit Evropian të Pagesave (EPC) më 14 tetor 2024.

## Politologu Albinot Maloku: Gërvalla-Shwarz, burim i vazhdueshëm skandalesh

Prishtinë, 12 nëntor - Politologu Albinot Maloku ka komentuar zhvillimet në vend, veçanërisht punën e ministres së Jashtme, Donika Gërvalla-Shwarz. Maloku në "Facebook" ka shkruar se energjia më negative dhe skajshmërisht skandaloze e republikës është ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla - Schwarz, e cila me e pa vetëdije ka punuar kundër Kosovës, por edhe kësaj qeverie. "Duke qenë burim i vazhdueshëm skandalesh, çdo mundësi për performancë diplomatike është shuar, dhe diplomacia kosovare ka shkuar



në rënie të plotë. Secili angazhim e veprim vetëm ka dëmtuar rëndë interesat e shtetit dhe imazhin ndërkombëtar të Kosovës. Prej që është shefe e diplomacisë së Kosovës, me veprimet e saj ka osciluar prej gabimeve e gafeve më qesharake, përmes dëmtimit të raporteve të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar e performancës skajshmërisht të dobët, e deri te skandalet. Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar, njohjet në adresë të Kosovës, e anëtarësimi i saj në mekanizma ndërkombëtar

janë veç fraza për Republikën, për katër vite rresht nën drejtimin e diplomacisë nga e përmendura. Puna e saj edhe brenda Zyrës së MPJD është e mbushur me kontradikta dhe mungesë vizioni, gjithësesi edhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në dështimin e objektivave kryesore të politikës së jashtme të Kosovës. Çfarë mund të presim më shumë nga një ministre që ka dështuar në çdo aspekt të detyrës së saj dhe që ka qenë një barrë për çdo mundësi të Republikës në skenën ndërkombëtare?", ka shkruar Maloku.

## Komuna e Podujevës, me objekt të ri të Urgjencës

Podujevë, 12 nëntor - Komuna e Podujevës ka njoftuar se të mërkurën prej orës 15:00 do të mbahet ceremonia e përvitit të objektit të ri të Urgjencës së qytetit.

Në këtë ceremoni do të marrin pjesë kryeministri Albin Kurti, kryetari i

komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, zyrtarë të Organizatës "Qatar Charity" (si bashkëfinancues të projektit) dhe zyrtarë të tjerë nga niveli qendror dhe lokal.

Ky objekt modern është ndërtuar në bashkëpunim

ndërmjet komunës së Podujevës dhe organizatës "Qatar Charity", ku 600 mijë euro janë investuar nga komuna, kurse 1.1 milion euro nga kjo organizatë. Përveç Urgjencës, aty parashihet të ofrohen edhe shërbime të tjera shëndetësore.



## Buxhet për zhvillim a mbijetesë?

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Për njohësit e çështjeve ekonomike në Kosovë, buxheti i propozuar për vitin 2025 është sa për mbijetesë e jo për zhvillim të vendit, siç e trumbeton qeveria. Vlera e tij kap 3.6 miliardë euro dhe është për 9 për qind më e lartë se buxheti i këtij viti. Në dekadën e fundit buxheti i Kosovës ka shkruar duke u rritur. Diferenca mes vitit 2015 dhe 2025 është mbi 2 miliardë euro. Nga institucionet qendrore të Kosovës, buxhetin më të lartë në vitin 2025 do ta ketë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më të voglin do ta ketë Zyra e Presidentes. Por, për ekonomistin Safet Gërxhaliu, qeveria duhet të ketë më shumë brenga sesa eufori. Sipas tij, indikatorët ekonomikë gjatë këtij viti, përfshirë thellimin e deficitit tregtar, mosrritjen e qëndrueshme ekonomike dhe mosshfrytëzimin e buxhetit aktual, nuk sinjalizojnë se buxheti i vitit të ardhshëm do të jetë në dobi të zhvillimit ekonomik. "Sot do të isha shumë i lumtur nëse do të dëgjoja se në Kosovë kanë ardhur katër kompani të huaja

të cilat kanë investuar dhe kanë krijuar nga dhjetë vende pune. Në ekonomi flitet me kalkulime dhe jo me emocione dhe politikë", thotë Gërxhaliu, i cili më herët ka shërbyer kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai shtoi se zyrtarët e qeverisë po "i shtrembërojnë të dhënat" për shkak të zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen më 9 shkurt. Për më tepër, tha ai, projektbuxheti i vitit 2025 nuk parashihet ndihmë për sektorin privat, nga i cili mbushet buxheti i shtetit. "Është varrosur dialogu dhe partneriteti publiko-privat. Sektori privat nuk është përfshirë në projeksione dhe në prezantime të projekteve. Sektori privat është futur në borxhe në bankat komerciale", thotë Gërxhaliu. Megjithatë, Kurti, gjatë fjalimit në Kuvend, përmendi rritjen e pagës minimale si dhe planin për rritjen e pagave të punëtorëve në sektorin publik, që parashihet në buxhetin e vitit të ardhshëm. "Sa më shumë para në llogarinë e familjes, aq më shumë aktivitet ekonomik për bizneset", sipas tij.



Profesori i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejd Bektashi, thotë se buxheti për vitin 2025 ka rritje por, prapëseprapë, mbetet më i ulëti në rajon. "Në Kosovë, nëse e krahasojmë vlerën e buxhetit me numrin e banorëve nga regjistrimi i fundit i popullsisë, rezultoni se për një banor buxheti siguron rreth 2 300 euro. Në Shqipëri me buxhetin e vitit 2025

sigurohen rreth 3 400 euro. Shtetet [e tjera] të rajonit kanë vlera edhe më të larta. Pra, nuk ka nevojë për mburrje", thotë Bektashi. Sipas tij, as shpërndarja e mjeteve për kategoritë buxhetore nuk ka elemente zhvillimore, por përkrahen skemat sociale dhe kategoritë për paga dhe mëditje. "Kjo shpërndarje, ku kemi më shumë ndarje për sektorin e

mbrojtjes sesa që kemi për arsim, shëndetësi dhe bujqësi, nuk mund të ofrojë mirëqenie, por as nuk premtim se do të ketë ndonjë përsheptim të zhvillimit ekonomik", shtoi Bektashi. Nga 3.5 miliardë euro sa parashihet të jetë buxheti i vitit të ardhshëm, pjesa më e madhe pritet të ndahet për kategorinë subvencione dhe transfere.

## Kuvendi miraton në lexim të parë buxhetin për vitin 2025

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 nëntor - Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar dhe miratuar në lexim të parë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Kosovës për vitin 2025 e paraqiti kryeministri i vendit, Albin Kurti. Fillimisht ai tha se është kryeministri i parë që e paraqet buxhetin për vitin e katërt, për ta shënuar me këtë rast edhe qeverinë e parë që e çon mandatin deri në fund. Kryeministri Kurti, duke e paraqitur buxhetin e vendit për vitin 2025, e quajti atë si buxhet historik, prej 3.6 miliardë eurosh. "Buxheti për vitin 2025 është 60 për qind më i lartë se ai në vitin 2020, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe një prioritet të fortë për



zhvillimin", tha Kurti, duke shtuar se ky buxhet për rritjen ekonomike, fokusohet në rritjen e Bruto Produktit

Vendor, mbështetjen e sektorit të prodhimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për qytetarët.

Ai shtoi se kjo qeveri e ka krijuar numrin më të madh të vendeve të punës. Krejt në fund, kryeministri

Kurti, duke kërkuar miratimin e këtij projektligji, vlerësoi se nga ky buxhet i përbashkët i shtetit tonë do të përfitojnë të gjithë si asnjëherë më parë. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Transfere, Armend Muja, dha sqarimet e nevojshme lidhur me shqyrtimin, miratimin dhe procedimin e këtij projektligji për seancë plenare nga komisioni funksional, duke treguar se Komisioni ka rekomanduar miratimin e tij. Muja theksoi se ky buxhet parashihet rritje në disa sektorë të rëndësishëm të shtetit dhe se buxheti i paraqitur për vitin 2025 do të jetë 3.6 miliardë euro. Pas shterimit të diskutimit të deputetëve lidhur me këtë projektligj, qëndrime për dhe kundër, Projektligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 u miratua nga deputetët me 59 vota për dhe dy abstenime.

## Hoti: Investimet kapitale të kësaj qeverie janë përgjysmë më të ulëta se në qeveritë paraprahe

Prishtinë, 12 nëntor - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se ekonomisë së Kosovës i mungojnë qindra miliona euro për shkak të mosrealizimit të investimeve kapitale të

planifikuara. "Rrugët rajonale, të nisura në qeveritë paraprahe, kanë mbetur në gjysmë në gjithë Kosovë. Projektet e reja të premtuara as që kanë nisur, si Aeroporti i Gjakovës, rruga për Tetovë, rruga për Plavë,

hekurudha për Durrës etj", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka thënë se realizimi i investimeve kapitale të kësaj qeverie është përgjysmë më i ulët se në qeveritë paraprahe. "Ja historiku i realizimit të

investimeve kapitale në disa qeveri: Qeveria Mustafa (2015-2017) 19%; Qeveria Haradinaj (2018-2019) 18%; Pandemia covid-19 (2020) 9.7% dhe Qeveria Kurti (2021-2024) 10%", ka shkruar Hoti.





# Format e qeverisjes që kanë "sunduar" botën

Në Perëndimin relativisht liberal, ne shpesh supozojmë se qeveritë në mbarë botën duhet të veprojnë sipas parimeve të ngjashme demokratike me ato perëndimore, me përfaqësues të zgjedhur, debate parlamentare etj. Por ja që ka një sërë sistemesh të ndryshme, duke filluar nga autokracia absolute – në formën e shteteve njëpartiake, diktaturave dhe regjimeve totalitare – deri te qasjet e bazuara në pjesëmarrje dhe debat publik.

Për më tepër, demokracia në vetvete nuk është aspak një koncept i vetëm, me versione të ndryshme të përkufizimit klasik në të gjithë botën.

Le të hedhim një vështrim në disa nga sistemet e ndryshme qeverisëse në botë. Në fund të fundit, ne nuk mund ta kuptojmë se si ndahet, transferohet, ruhet dhe zbatohet pushteti – ligjor, ekzekutiv e jo vetëm, nëse nuk i kuptojmë strukturat e shumta mbi të cilat ai ngrihet.

## Demokracia përfaqësuese

Një sistem në të cilin publiku zgjedh përfaqësuesit e tij përmes një procesi të rregullt votimi. Shumica dërrmuese e demokracive perëndimore janë ndërtuar rreth kësaj metode



përzgjedhjeje.

Shembull: Mbretëria e Bashkuar, ku anëtarët e Parlamentit zgjidhen përmes votimit të popullit në 650 zona parlamentare.

## Demokracia parlamentare

Një grup përfaqësuesish të zgjedhur formojnë një parlament në këtë sistem, i cili më pas emëron një drejtues ekzekutiv si kreun e qeverisë, i cili mund të votohet dhe rrëzohet nga pushteti – ndryshe nga një president, i cili nuk mundet.

Shembull: Gjermania, ku Bundestagu (përfaqësuesit e zgjedhur të popullit) emërojnë një kancelar (Bundeskanzler).

## Demokracia presidenciale

Një sistem presidencial ndryshon nga një demokraci parlamentare në atë që kreu i shtetit zgjidhet nga publiku, në vend që të emërohet nga legjislativi, dhe si i tillë zakonisht nuk mund të shkarkohet nga legjislativa në fjalë.

Shembull: Shtetet e Bashkuara, ku presidenti drejton degën ekzekutive, ndërsa dega ligjore vepron jashtë kompetencave të tij.

## Demokracia kushtetuese

Një demokraci quhet kushtetuese nëse ajo funksionon sipas parimeve ose politikave të regjistruara në një kushtetutë, një dokument, përmbajtja e të cilit miratohet nga dega publike dhe/ose ligjore e vendit.

Shembull: Zvicra, kushtetuta e së cilës përcakton ndarjen e vendit në 26 kantone dhe e cila është përditësuar së fundmi në vitin 2000.

## Demokracia e drejtpërdrejtë

Në këtë sistem, popullsia e një vendi, qyteti ose njësie merr vendimet e veta për politikën pa u dashur që një grup përfaqësuesish ta bëjnë këtë për ta.

Shembull: Qyteti-shtet i Athinës rreth vitit 600 pes operonte një formë të demokracisë së drejtpërdrejtë; një shembull më modern është Lihtenshtejni. Shumë vende kanë gjithashtu referendume, një koncept i lidhur ngushtë me demokracinë



e drejtpërdrejtë.

## Demokracia liberale

Sipas këtij sistemi, një qeveri kërkon të përfaqësojë elektoratin e saj me një theks relativisht të fortë mbi hapjen, barazinë, përgjegjshmërinë (kontrollet dhe ekuilibrat) dhe ndarjen e pushteteve, përgjithësisht me më shumë se një parti që merr pjesë në zgjedhje.

Shembull: Islanda, ku qeveritë e koalicionit shihen si normë dhe politikën janë shpesh me natyrë progresive.

## Demokracia sociale

Një aspekt kryesor i një demokracie sociale është se ajo fokusohet në nevojat e qytetarëve të saj, duke krijuar një sistem të mirëqenies, për shembull. Vini re se socializmi demokratik, një qasje e lidhur me të, por jo identike, e vë më shumë theksin në qëllimin e ndërtimit të një shoqërie socialiste.

Shembull: Afrika e Jugut, ku qeveritë e kanë ndjekur këtë qasje që nga viti 1994, me shkallë të ndryshme suksesi.



## Demokracia me pjesëmarrje

Ky sistem lejon publikun e një vendi, ose një pjesë të përzgjedhur të tij, të përfshihet drejtpërdrejt në politikëbërje dhe në qeverisje, me ose pa praninë e përfaqësuesve të zgjedhur.

Shembull: Irlanda, ku një Asamble Qytetare u formua në vitin 2011 për të përfshirë publikun në hartim politikash. Mediat sociale janë gjithashtu një forum i diskutueshëm për demokracinë pjesëmarrëse.

## Demokracia debatuuese

Çdo demokraci që përfshin një element debati, argumenti, diskutimi dhe peshimi të opsioneve të shumta nga një grumbull njerëzish përpara se të ndërmerren veprime, mund të thuhet se është debatuuese.

Shembull: Asambleja Qytetare e Belgjikës ka diskutuar mbi politikën e vendit që nga viti 2019 dhe ka kompetencat e veta legjislative.

## Demokracia konsociative

Nëse grupe qytetarësh me etni, fe ose vlera të tjera të ndryshme punojnë së bashku brenda një demokracie për të ndarë pushtetin politik dhe ligjor në dobi të të gjithë pjesëmarrësve, ata kanë një sistem konsocial.

Shembull: Midis 1857 dhe 1967 Holanda i ndau pushtetet midis katër grupeve – dy fetare, njëri politik dhe një jo i specifikuar.

## AUTOKRACITË

### Monarkia absolute

Kur një monark zotëron pushtet absolut në vendin e tij, i pakufizuar nga kufijtë ligjorë, ai është kreu i një monarkie absolute. Këto nuk ekzistojnë më



në Perëndim, përveç qytetit të Vatikanit dhe (ndoshta) Lihtenshtejnit.

Shembull: Omani, ku Sulltani dhe Kryeministri Haitham bin Tarik zotërojnë të gjitha fuqitë ligjore.

## Diktatura

Një sistem në të cilin një individ i vetëm, ose një grup i vogël individësh, ruan të gjithë pushtetin është një diktaturë. Në zakonisht i shohim sisteme të tilla negativisht, por ekziston gjithashtu koncepti i një 'diktature dashamirëse', megjithëse shembuj të tillë janë të rrallë.

Shembull: Gjermania naziste, diktaturë e cila ekzistoi nga viti 1933 deri në vitin 1945, udhëhiqte nga diktatori Adolf Hitler dhe grupi i tij i ministrave.

## Regjimi totalitar

Totalitarizmi është besimi se shoqëria mund dhe duhet të organizohet sipas një vizioni të vetëm, të përsosur dhe se detyra e një vendi është të përparojë drejt atij vizioni me çdo kusht.

Shembull: Koreja e Veriut, ku dinastia e liderëve Kim zbaton një ideologji izolacioniste, të bazuar në komunizmin e mbështetur te vetvetja.

## Regjimi autoritar

Nëse një qeveri kontrollon qytetarët e saj me ligje të rrepta, frenon liritë e tyre personale, politike dhe liritë e tjera dhe përdor forcat policore ose ushtarake për t'i nënshtruar, ky është një shembull i autoritarizmit.

Shembull: Siria, ku shkeljet e të drejtave të njeriut janë raportuar si ndër më të këqijat në botë.

## Junta ushtarake

Junta ("këshill në spanjisht), kur

formohet nga pjesëtarë të forcave të armatosura të një vendi, quhet juntë ushtarake. Një organizatë e tillë ose mund ta krijojë një qeveri, ose mund ta zëvendësojë një të tillë.

Shembull: Burkina Faso, ku Lëvizja Patriotike për Mbrojtje dhe Rivendosi ka sunduar që nga grushti i shtetit në vitin 2022.

## Teokracia

Qeveria teokratike është sundimi i një vendi nga një Perëndi nëpërmjet dishepujve të tyre, të cilët ekzekutojnë punët e qeverisjes sipas dogmës së fesë së tyre.

Shembull: Afganistani, i cili udhëhiqet nga talebanët, të cilët qeverisin sipas interpretimit të tyre të ligjit të shariatit islam.

## Shteti njëpartiak

Një shtet njëpartiak lejon vetëm një parti të vetme të marrë pjesë në zgjedhje dhe të qeverisë.

Partitë e tjera konsiderohen të paligjshme (ose sanksionohen nga partia në pushtet për të luajtur një rol mbështetës), duke siguruar që pushteti qeveritar të ruhet përgjithmonë nga i njëjti grup politik.

Shembull: Kina, ku Partia Komuniste Kineze ka qeverisur vendin që nga viti 1949.

## Regjimi hibrid

Ndërsa në procesin e lëvizjes nga njëri skaj i spektrit autoritar-kundrej-liberal në tjetrin, një shtet hibrid është një vend që thjesht zotëron elementë të të dy sistemeve.

Shembull: Brazili, i cili në vitet e fundit nën Presidentin Bolsonaro, kishte kaluar një proces autokratizimi duke ruajtur elementë të politikës liberale.

## SISTEME TË TJERA

### Oligarkia



Çdo sistem në të cilin pushteti është në duart e një grupi relativisht të vogël individësh mund të përshkruhet si oligarki. Këta oligarkë zakonisht zotërojnë pasuri të konsiderueshme, qoftë të trashëguara, të vjedhura, të dhëna nga shteti i tyre apo të fituara nëpërmjet përpjekjeve kapitaliste.

Shembull: Rusia, shumë prej oligarkëve të së cilës fituan shuma të mëdha parash në vitet menjëherë pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

### Aristokracia

Nëse një klasë individësh të pasur, të privilegjuar, shpesh me pasuri të trashëguara dhe – në vendet me sisteme titujsh – tituj nderi, sundojnë një vend, kjo është një aristokraci.

Shembull: Mbretëria e Bashkuar është pjesërisht një aristokraci për shkak të ekzistencës së Dhomës së Lordëve, e cila mund të vonojë ligjet e reja nga Dhoma e Ulët. Derisa kompetencat e saj u zvogëluan në vitin 1911, Lordët mund të vendosnin veton ndaj projektligjeve të miratuara nga Dhoma e Ulët. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Gjyqtarët e Kosovës caktohen për t'i drejtuar ndeshjet ndërkombëtare

Gjyqtarët e Kosovës gjithnjë e më shumë janë të pranishëm në ndarjen e drejtësisë në ndeshjet ndërkombëtare. Disa prej tyre janë deleguar nga UEFA për kompeticione e ndryshme të ndeshjeve të këtij muaji.

Gjyqtari Mervan Bejtullahu dhe asistenti Edmond Zeqiri do të ndajnë drejtësinë në ndeshjet mes Gjeorgjisë me Suedinë, e cila zhvillohet të mërkurën mbrëma, pastaj në sfidën në mes të Norvegjisë e Gjeorgjisë

më 16 nëntor dhe në takimin ndërmjet Suedisë e Norvegjisë, më 19 nëntor, në kuadër të Evropianit U-19. E gjyqtari Visar Kastrati dhe asistenti Fatlum Berisha do ta ndajnë drejtësinë në "UEFA REGIONS' CUP". Ata

do të referojnë në ndeshjet San Marino - Hungaria (13 nëntor), Stambolli - San Marino (16 nëntor) dhe Hungaria - Stambolli (19 nëntor). Ndërkaq, gjyqtari Alvan Shala dhe asistenti Drilon Rexhepi do ta

ndajnë drejtësinë në "UEFA UNDER-19 Championship". Më saktësisht, ata do të referojnë në ndeshjet Spanja - Ishujt Faroe (13 nëntor), Austria - Ishujt Faroe (16 nëntor) dhe Austria - Spanja (19 nëntor).



## Krasniqi dhe Bytyqi: Presim ta vazhdojmë serinë e fitoreve

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 12 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka mbajtur të martën stërvitjen e dytë në kuadër të përgatitjeve për dy ndeshjet e fundit në Ligën e Kombeve. Gjatë kësaj seance përgatitore, përzgjedhësi Franco Foda është fokusuar tek aspekti taktik, duke përshtatur strategjitë për ndeshjen ndaj Rumanisë dhe duke u kushtuar vëmendje detajeve që mund ta bëjnë diferencën në fushë. Në këtë stërvitje munguan kapiteni Amir Rrahmani, i cili bëri seancë rigjenerimi në hotel dhe Mërgim Vojvoda, i cili, për shkak të një shqetësimi të vogël në shpinë nga stafi, u vendos të pushojë. Ndërkohë, Leard Sadriu ka vazhduar stërvitjet e diferencuara për shkak të lëndimit të gishtit të dorës, të pësuar në ndeshjen e

fundit me klubin e tij. Futbollisti Ilir Krasniqi ka thënë se atmosfera është e mirë, derisa Kosova do të mundohet ta vazhdojë serinë pozitive prej tri fitoresh radhazi. "Atmosfera është fantastike. Djemtë janë të motivuar për lojën e ardhshme që e kemi. E dimë se është një lojë mjaft e rëndësishme dhe secili djalë që është këtu po e bën maksimumin për t'u përgatitur sa më mirë dhe shpresojmë që do të kemi rezultat pozitiv", ka thënë Krasniqi. "Këto rezultate pozitive janë edhe për shkak të atmosferës së mirë që është në ekip dhe besoj se lojtarët janë të motivuar për të luajtur dhe pasi i kemi tri fitore në tri ndeshje, besoj se do ta vazhdojmë këtë seri. E dimë që është një kundërshtar mjaft i vështirë sepse është në pozitën e parë, por mendoj që me grupin që e kemi do të bëjmë

mjaft mirë", ka shtuar Krasniqi. Pas stërvitjes ka folur edhe futbollisti sulmues i Kosovës, Zymer Bytyqi, i cili fillimisht ka shprehur kënaqësinë se është rikthyer sërish në radhët e "dardanëve". "Jam shumë i lumtur që jam ftuar përsëri. Tash jam këtu dhe jam shumë i kënaqur. Ta them të drejtën, është si një fillim i ri, ka plot lojtarë të rinj që kanë ardhur dhe që do të gëzohem që t'i njoftoj", ka thënë Bytyqi, i cili beson se në ndeshjen ndaj Rumanisë presin rezultatin që do t'i mundësojë Kosovës të fitojë grupin. "Rëndësia është shumë e madhe për këtë lojë. Besoj se do ta japim maksimumin tonë. Shpresoj se do ta kemi një rezultat të mirë që na ndihmon ta fitojmë këtë grup", ka shtuar Bytyqi. Stërvitjen e radhës "dardanët" e zhvillojnë sot (e mërkurë) në orën 11:00 në Kampin Nacional në Hajvali.

### SHKURT

#### Shtyhet ndeshja e Trepçës për shkak të vizave

KB Trepça ka njoftuar se ndeshja e tyre ndaj Caledonia Gladiators në FIBA Europe Cup e planifikuar pas dy ditësh është shtyrë. Arsyeja është absurde, teksa klubi mitrovicas njofton se shkak i vonesave nga administrata ende nuk ka marrë vizë. "Ndeshja e xhiros së VI në kuadër të Grupit H në mes të Caledonia Gladiators dhe Trepça e planifikuar të zhvillohet me datë 13.11.2024 është shtyrë për një datë tjetër si pasojë e vonesave administrative në procesin e vizave hyrëse për Britani të Madhe", thuhet në njoftimin e Trepçës.

#### Ardian Ismajli, 100 ndeshje në Serinë A

Të premten kundër Lecces, Ardian Ismajli luajti ndeshjen e tij të 100 në Serinë A. Mbrojtësi shqiptar debutoi në elitën e futbollit italian më 1 nëntor të vitit 2020 në ndeshjen Spezia - Juventus me fanellën e skuadrës nga Liguria. 28-vjeçari koleksionon deri tani 87 paraqitje me Empolin dhe 13 me Spezian në Serinë A. Ismajli është kthyer në një titullar të padiskutueshëm të skuadrës së Empolit dhe një nga kolonat e mbrojtjes së kombëtares shqiptare. Mbrojtësi ka zhvilluar 42 ndeshje me Shqipërinë dhe ka shënuar 3 gola.

#### Lojtari i Rumanisë: Shpresojmë të një rezultat pozitiv ndaj Kosovës

Rumania do të përballet me Kosovën në Ligën e Kombeve. Lojtari i rumunëve, Razvan Marin, në një intervistë të dhënë, tha se pret që në këtë takim të mos ketë probleme, si në rastet e kaluara, ku nuk munguan incidente me flamuj provokues. "Të premten me Kosovën shpresojmë të jenë 50 mijë tifozë. Na vjen mirë që janë me ne. Shpresoj t'i kënaqim me një rezultat pozitiv në fund. Shpresoj të mos ketë probleme dhe të luajmë në fushë. Tashmë janë ndarë mesazhe të caktuara që të jemi të qetë dhe të mos ketë probleme. Me siguri që edhe tifozët tanë do ta fishkëlajnë himnin e tyre. Ne ende shpresojmë që nuk do ta bëjnë, por do të shohim", ka thënë Marin.

## Lindon Emërllahu, 'Ylli i javës' në Superligë

**PRISHTINË, 12 NËNTOR** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës Albi Mall vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 13-të i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Lindon Emërllahu.

Pasi mori këtë çmim, Emërllahu u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës: "Vlerësimi si më i miri i javës është një motiv shtesë për të punuar edhe më shumë për punën e mëtejshme. Loja

kundër Malishevës ishte shumë e rëndësishme për skuadrën tonë, sepse ishim të vetëdijshëm që po ndesheshim me një skuadër me shumë cilësi por, megjithatë, ne treguam forcën tonë si grup dhe në

momentet vendimtare të ndeshjes ishim më të mirë. FC Ballkani do ta vazhdojë ritmin e njëjtë të punës edhe më tutje, sepse na pret një rrugë e gjatë deri në fund të kampionatit për t'u rikonfirmuar si kampion".



## Ronaldo dhe 1 000 golat në karrierë: Sido që të ndodhë, jam shënuesi më i mirë në histori

LISBONË, 12 NËNTOR - Cristiano Ronaldo u shpërblye si "ambasador ekselent" i Portugalisë në "Quinas de Ouro Gala". Me këtë rast, pesë herë fituesi i "Topit të Artë" foli për të gjitha mediet e pranishme: "Jam krenar që e marr këtë trofe. Nuk e shoh si fund, por si fillim. Falënderoj Federatën Portugeze të

Futbollit për këtë çmim, për rrugëtimin e gjatë që bëra në ekipin kombëtar me kaq shumë krenari dhe punë të palodhur. Kur u bashkua me kombëtaren, në moshën 18-vjeçare, ëndrra ime ishte të luaja të parën ndeshje ndërkombëtare, pastaj 25, 50, 100". Mentaliteti i Ronaldos

shpjegohet në mënyrë perfekte nga ky fjalim i tij: "Tashmë pyes veten: Pse jo 150, 200 ndeshje? Kombëtarja është një ndjenjë fantastike, ndaj do të doja t'u thosha shokëve të mi: pasi kam fituar kaq shumë trofe, nuk shoh asgjë më të mirë se ta përfaqësoj vendin, kulturën, kombin, prindërit, fëmijët". Shumë i kërkojnë atij

të arrijë 1000 gola në karrierë, por CR7 "fajëson" veten se e ka ngritur stekën shumë lart: "Do të jem i singertë, është faji im, sepse tani e shoh jetën si ta jetoj në këtë moment, nuk mund të mendojmë gjatë. Dua të shijoj të tashmen. Vetë thashë se doja të arrija 1000 gola, por nuk e di nëse do t'ia dal. Megjithatë, jam ende



lojtari me më shumë gola në histori, kështu që është mirë".

## Ancelotti: Para pensionit dua të fitoj një tjetër Ligë të Kampioneve

MADRID, 12 NËNTOR - Në një intervistë të gjatë, dhënë për "France Football", trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, foli kështu për marrëdhëniet me lojtarët e tij e më gjerë. "Unë jam mik me lojtarët e mi dhe dua të jem. Ata mund të flasin me mua për çdo gjë. Unë u them atyre hapur: Dua të ndërtoj një marrëdhënie të mirë me ju". Trajneri italian ka vlerësuar se Milani dhe Real Madridi janë dy klubet më të mira që ka drejtuar, derisa për lojtarë ka thënë se e ka të pamundur të bëjë një njëmbëdhjetëshe, pasi numri i lojtarëve kualitativë që ka drejtuar ka qenë i madh. "Për klubet më të mira mund të përgjigjem: Milani dhe Real Madridi. Sa për ekipin më të mirë, është e vështirë të flas. Unë kam pasur nderin të menaxhoj lojtarë dhe ekipe fantastike. Nuk mund t'i rendis lojtarët më të mirë që kam stërvitur. 11-shja ime më e mirë nuk ekziston. Është e pamundur ta përzgjedh atë. Çfarë lojtarësh të jashtëzakonshëm kam



stërvitur, pa dallime", ka thënë Ancelotti. Ndërsa për objektivin që synon ta arrijë para pensionimit, Ancelotti ka thënë se e synon edhe një titull të Ligës së Kampioneve. "Para se të ndaloj së trajnuari do të doja të fitoja një Ligë të re të Kampioneve. Dhe pastaj një tjetër (qesh). Çdo trajner dëshiron të arrijë në majë, por ta stërvitësh Real Madridin është vërtet e veçantë. Është klubi më i mirë në botë për historinë, atmosferën, tifozët e tij. Pastaj është Milani, klubi më i mirë për të studiuar

futboll. Unë pata mundësinë t'i stërvitja të dy këto klube të mëdha", ka shtuar ai. I pyetur se cila ka qenë dhoma më e vështirë e zhveshjes për ju si trajner, Ancelotti ka deklaruar: "Patjetër që e Napolit. Nuk është e lehtë ta shpjegoj pse, individualisht ishte e mirë. Kishte ndryshime në krahasim me epokën e mëparshme të Sarrit. Unë doja të ndryshoja disa gjëra dhe kjo e nxori jashtë ekuilibrit dhomën e zhveshjes së Napolit. Megjithatë, punuam mirë sezonin e parë, ndërsa i dyti ishte i vështirë".

### SHKURT

#### Trabzonspori largon Enis Bardhin nga ekipi i parë

Trabzonspori ka marrë një vendim që katër lojtarë janë larguar nga ekipi i parë dhe janë transferuar për të punuar veçmas në periudhën e ardhshme. Në mesin e tyre është edhe kapiteni i përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut, Enis Bardhi. "Si rezultat i takimit në mes të presidentit Ertugrul Dogan, zëvendës-presidentit Zeyat Kafkas dhe trajnerit Shenol Gunesh, është vendosur që futbollistët tanë Mislav Orsiç, Stefano Dansvil, Enis Bardhi dhe Umut Bozok të stërviten veçmas për ta përmirësuar performancën e tyre", kanë njoftuar nga klubi. Bardhi i cili është me Trabzonsporin që nga viti 2022, këtë sezon ka gjithsej 13 paraqitje në të gjitha garat për ekipin, tetë prej tyre në kampionatin turk, dy në kualifikueset e Ligës së Konferencës dhe tri në kualifikueset e Ligës së Evropës.

#### Shefi i Ferrari: Synojmë titullin kampion për konstruktorë

Te Ferrari janë të kënaqur këtë sezon me pesë fitore të arritura në Botërorin e Formulës 1. "Kokëkuqja" është ende në garë për titullin kampion për konstruktorë dhe shpreson të rikthehet te fitorja në garën e radhës në Las Vegas. "Do të jetë një mundësi e mirë për të fituar, pasi është një pistë që na përshtatet. Botërori i këtij viti është ende i hapur, ndaj shpresojmë ta fitojmë atë duke parë kapacitetet që kanë të dy pilotët tanë", ka thënë Frederic Vasseur, shefi i Ferrarit. Gjithsesi, kur kanë mbetur edhe tri gara nga mbyllja e këtij botërori, te Ferrari janë duke menduar edhe për vitin 2025. Këtë gjë e konfirmon menaxheri francez: "Prej muajsh jemi përqendruar te projekti i vitit të ardhshëm". "Këtë sezon ka pasur mjaft risi që janë në funksion të asaj që do të ndodhë pas një viti. Ne kemi mjaft besim dhe shpresa si në tri garat e mbetura ashtu dhe në sezonin që do të vijë, kur do të kemi Hamilton në timon", ka shtuar Vasseur.

#### Vdes futbollisti 22-vjeçar pas aksidentit automobilistik

Një futbollist nga Ekuadori ka ndërruar jetë pas një aksidenti automobilistik të pësuar një javë më parë. Bëhet fjalë për Marko Angulon. 22-vjeçari ndodhej në koma artificiale dhe, pavarësisht prej përpjekjeve të mjekëve, ai nuk arriti të shpëtonte. Në një deklaratë zyrtare, klubi ku ai luante, LDU Quito, shprehu ngushëllimet: "Ne shprehim ngushëllimet tona më të thella për familjen dhe miqtë e Markos. Vdekja e tij është një humbje e thellë që do të përjetohet përgjithmonë brenda klubit dhe komunitetit tonë". Angulo i ishte bashkuar LDU Quito si huazim nga Cincinnati i MLS në fillim të këtij viti, duke shfaqur potencialin e tij në fushën e kryeqytetit që nga marsi.

## Clevelandi komandon në NBA, triumfojnë edhe Oklahoma e San Antonio

CHICAGO, 12 NËNTOR - Ekipi i Clevelandit vijon të dominojë këtë sezon në NBA, duke korrur sot fitoren e 12-të radhazi (ende asnjë humbje). Cavaliersi fitoi me rezultat 119-113 në fushën e Chicagos, ku protagonist ishte Donovan Mitchell, autor i 36 pikëve. Fitoi skuadra e San



Antonios, që mundi me rezultat 116-96 Sacramenton, ndeshje Victor Wembayama realizoi 34 pikë e 14 reboundeve për Spursin.

Një triumf në sekondat e fundit për Brooklynin, që mundi me rezultat 107-105 New Orleansit jashtë fushës (7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë). Skuadra e Oklahomës rikthehet te fitorja, duke mundur me rezultat 134-128 Clippersave dhe udhëheq në Perëndim. Alexander Shai me 45 pikë ishte lider për Oklahomën. Ekipi i Houstonit, falë 27 pikëve e 17 reboundeve të Sengunit, mundi me rezultat 107-92 Washingtonit.

### REZULTATET

Chicago - Cleveland	113-119
Houston - Washington	107-92
New Orleans - Brooklyn	105-107
Oklahoma - Clippers	134-128
San Antonio - Sacramento	116-96

## Rodri: Viniciusin do ta votoja vetëm të tretin për 'Topin e Artë'

Mesfushori i Manchester Cityt dhe Spanjës, Rodri, ka folur tashmë për "Topin e Artë" dhe në veçanti për rivalin e tij, Vinicius Jr. Brazilianit iu mohua "Topi i Artë" i vitit 2024, pavarësisht se konsiderohej favorit për të fituar,

pasi në fund fitues ishte Rodri. Diferenca mes dy yjeve ishte shumë e ngushtë dhe tashmë për këtë situatë ka folur vetë Rodri, i cili ka thënë se Vinin do ta votonte vetëm si të tretin. "Unë do ta votoja Dani Carvajalin për

të dytin në 'Topin e Artë' 2024... dhe Vinicius Jr si të tretin", ka thënë Rodri në intervistë për gazetën spanjolle "Cope". Rodri nuk përmendi fare as Jude Bellingham, i cili performoi shkëlqyeshëm sezonin e kaluar

dhe përfundoi i treti në garën zyrtare për "Topin e Artë". Më tej Rodri deklaroi se ai e respekton Viniciusin pavarësisht një kënge ofenduese për lojtarin që po këndohej në festën e tij të "Topit të Artë". "Njerëzit duhet ta

kuptojnë sportin e shëndetshëm dhe se është një festë private, një moment feste. Asnjëherë nuk kam shpërfillur askënd. Kam respekt të jashtëzakonshëm për Viniciusin dhe Real Madridin", ka deklaruar Rodri.



## RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:** Udhëheqës/e  
**Grada e pozitës:** 3.a.a  
**Kohëzgjatja e punësimit:** Me afat të pacaktuar  
**Njësia:** Njësia e Auditimit të Pajtueshmërisë (NJAP)  
**Raporton tek:** Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm

### QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS:

Udhëheqësi/ja i/e kësaj njësie udhëheq dhe mbikëqyr Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë, si dhe në përgjithësi do të jetë përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me këtë njësi. Ai/Ajo punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm.

### Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

#### Auditimet e Brendshme:

- Së bashku me Udhëheqësin/en e Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative, përgatisin Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm nën mbikëqyrjen dhe miratimin e Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Së bashku me Udhëheqësin/en e Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative, përgatisin Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm bazuar në "Qasjen në Rrezik" nën mbikëqyrjen dhe miratimin e Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Komunikon rezultatet e angazhimeve të auditimit dhe detyrave të këshillimit për Menaxhmentin, përmes Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Finalizon draft-raportet e përgatitura nga auditorët e kësaj njësie, për miratim nga Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm dhe i dërgon tek Menaxhmenti për komente eventuale;
- Mban takime përmbyllëse me drejtorët e departamenteve dhe Menaxhmentin për diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, si dhe planin e veprimit të Menaxhmentit;
- Përgatit përcjelljen e implementimit të rekomandimeve për raportim tek Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm cakton ekipin e auditimit nëpër auditime të rregullta.
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm cakton ekipet e auditimit në auditimet/angazhimet tjera të përcaktuara në Statutin e Auditimit të Brendshëm.

#### Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Gjatë ushtrimit të detyrave, kujdeset që personalisht dhe auditorët e kësaj njësie janë duke iu përmbytur Ligjit të BQK-së, Statutit të Auditimit të Brendshëm, Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, si dhe rregullave tjera të brendshme të BQK-së;
- Bashkë me auditorët, mund të marr pjesë në takime që kanë karakter vëzhgues apo këshillëdhënës gjatë implementimit të programeve të ndryshme;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm dhe bashkërisht me Udhëheqësin/en Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative cakton objektivat afatgjata të Auditimit të Brendshëm;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm, përgatit propozimet e planit të trajnimeve dhe buxhetit vjetor për Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë;
- Kryen detyra të tjera që mund t'i caktohen nga Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë këtu edhe angazhimin në auditime.

#### Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marr pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të personelit në Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/sajë në dobi të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Auditimit të Brendshëm, brenda sajë.

#### PËRGATITJET PROFESIONALE/KUALIFIKIMET:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, biznesit, menaxhmentit, apo juridike;
- Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tri (3) vite në auditim të brendshëm;
- Tri (3) vite përvojë menaxheriale ose përvojë në udhëheqjen e ekipeve të auditimit;
- Certifikatë profesionale në auditim të brendshëm apo të jashtëm të sektorit publik/privat;
- Të ketë njohuri shumë të mira mbi Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm;
- Aftësi të larta të planifikimit, organizative dhe drejtuese;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe personelin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar personelin dhe për të menaxhuar me sukses punët e njësies;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioritetëve;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja shumë e mirë e gjuhës angleze paraqet përparësi;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

#### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Kopjen e certifikatës profesionale;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

#### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 nëntor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

**Naziv radnog mesta:** Rukovodilac/lja  
**Rang pozicije:** 3. a. a  
**Trajanje zaposlenja:** Na neodređeno vreme  
**Jedinica:** Jedinica za reviziju usklađenosti (JRU)  
**Izveštava:** Šefu unutrašnje revizije

### Svrha i delokrug pozicije:

Rukovodilac/lja ove jedinice vodi i nadzire Jedinicu za reviziju usklađenosti, te će uopšte biti odgovoran/na za pitanja koja se odnose na ovu jedinicu. On/ona radi pod direktnim nadzorom šefa/ice unutrašnje revizije.

### Delokrug posla za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

### Dužnosti i odgovornosti:

#### Unutrašnje revizije:

- Zajedno sa rukovodiocem/ljem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija pripremaju Strateški plan unutrašnje revizije pod nadzorom i odobrenjem šefa/ice unutrašnje revizije;
- Zajedno sa rukovodiocem/ljem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija pripremaju Godišnji plan unutrašnje revizije na osnovu „Pristupa rizika“ pod nadzorom i odobrenjem šefa/ice unutrašnje revizije;
- Saopštava rezultate revizorskih angažmana i savetodavnih zadataka, preko šefa/ice unutrašnje revizije;
- Finalizira nacerte izveštaja pripremljenih od strane revizora ove jedinice, na odobrenje od strane šefa/ice unutrašnje revizije i šalje ih Rukovodstvu za eventualne komentare;
- Održava završne sastanke sa direktorima odeljenja i Rukovodstvom radi razmatranja nalaza i preporuka, kao i akcionog plana Rukovodstva;
- Priprema praćenje sprovođenja preporuka za izveštavanje šefu/ici unutrašnje revizije;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, imenuje revizorski tim za redovne revizije.
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, raspoređuje revizorske timove za revizije /druge angažmane definisane Statutom unutrašnje revizije.

#### Sistemi/procedure i administrativna pitanja:

- Tokom obavljanja dužnosti, vodi računa da se lično i revizori ove jedinice pridržavaju Zakona CBK-a, Statuta unutrašnje revizije, Priručnika unutrašnje revizije, Etičkog kodeksa, kao i drugih unutrašnjih pravila CBK-a;
- Zajedno sa revizorima može učestvovati na sastancima koji imaju posmatrački ili savetodavni karakter tokom realizacije različitih programa;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije i zajedno sa rukovodiocem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija, postavlja dugoročne ciljeve unutrašnje revizije;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, priprema predloge plana obuke i godišnjeg budžeta za Jedinicu za reviziju usklađenosti;
- Obavlja i druge poslove koje može poveriti šef/ica unutrašnje revizije, uključujući angažovanje u reviziji.

#### Obuka i razvoj:

- Spremnost da učestvuje u relevantnim obukama za unutrašnje revizije, kao i da pruži odgovarajuću pomoć ostatku osoblja u Jedinici za reviziju usklađenosti;
- Da dokaže da on/ona razvija svoje sposobnosti u korist Centralne banke Kosova i unutrašnje revizije, u okviru nje.

#### Stručne pripreme/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, biznisa, menadžmenta ili prava;
- Najmanje sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva u reviziji, od čega najmanje tri (3) godine u unutrašnjoj reviziji;
- Tri (3) godine menadžerskog iskustva ili iskustvo u vodenju revizorskih timova;
- Profesionalni sertifikat za unutrašnju ili spoljnu reviziju javnog/privatnog sektora;
- Da poseduje veoma dobra saznanja o Globalnim standardima unutrašnje revizije;
- Visoke sposobnosti planiranja, organizacije i upravljanja;
- Sposobnost prilagodavanja prioritetima i zahtevima, rokovima kroz visok nivo analitičkih sposobnosti i veština rešavanja problema;
- Sposobnosti komunikacije i saradnje, uključujući sposobnost kreiranja i održavanja odnosa poverenja sa nadređenim i osobljem kojim rukovodi;
- Sposobnost motivisanja osoblja i uspešnog vođenja poslova jedinice;
- Preciznost, pažnja prema detaljima i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje upotrebe softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Vrlo dobro poznavanje engleskog jezika je prednost;
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturalnom okruženju.

#### Svi kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono pismo) u kojem se naglašava interesovanje i podobnost za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu**, (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje obavljanja funkcije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj od Fonda za penzione štednje Kosova (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od strane Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate /nostrifikovane od strane MONT-a;
- Kopija stručnog sertifikata;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

#### Procedura apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **29 Novembar 2024**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za apliciranje se neće razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Pusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 13.11.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

## KONKURS

### Pozita : Kordinator Operativ - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë  
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar  
Koeficienti i pagës 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon caktimin e ngasësve në automjete;
- Përpllon orarin e punës së ngasësve dhe mbanë evidencë mbi orët e punës dhe me kohë ia dorëzon menaxherit operativ;
- Sipas kërkesës dhe nevojës së procesit të punës përcjell dhe kontrollon kryerjen e punëve në punëtorinë e mirëmbajtjes në ndërrimin e tij;
- Organizon dhe koordinon punën e gjithmbarëshme në bartjen e mbeturinave;
- Kujdeset për angazhimin e plotë të të punësuarëve në funksion të ofrimit të shërbimit të bartjes së mbeturinave;
- Në bashkëpunim me menaxherët e ndërrimeve, kryepunëtorët dhe përgjegjësit e zonave, harton dhe përcjell zbatimin e orarit të kryerjes së shërbimeve në bartjen e mbeturinave;
- Harmonizon planet operative të shërbimeve në kuptimin e shfrytëzimit optimal të kapacitetit teknik dhe fuqisë punëtore, si dhe zvogëlimin e shpenzimeve operative;
- Përcjellë shfrytëzimin racional të kapacitetit teknik;
- Në bashkëpunim me vartësit plotëson urdhëresat e punës për paga dhe prezencë në punë;
- Detyrohet të inkurajojë zbatimin e kodit etik dhe rregullat e caktuara për këtë proces pune brenda departamentit të tij dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi për raportimin / adresimin e tyre dhe KE;
- Është përgjegjës për rregullsinë teknike të automjeteve dhe pastërtinë e tyre me rastin e daljes në rrugë të automjetit (kamionit);
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga menaxheri operativ.
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

#### a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

#### b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkollim i mesëm - përparësi drejtim nga Fakulteti Teknik;
- Përvoja e punës së paku 2 vite, e dëshmuar;
- Ai/Ajo duhet të ketë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, si dhe aftësi ndër njerëzore;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);

### Pozita : Zyrtar Ligjor - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë  
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar  
Koeficienti i pagës 3.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përfaqëson Kompaninë në gjykata në kontestet gjyqësore duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike në bazë të autorizimit nga eprori linear;
- Përgatit përgjigjet në padi duke u kujdesur se ajo është e kompletuar dhe përgatitur në mënyrë profesionale, bashkëngjit provat përkatëse, gjithnjë nën mbikqyrje të menaxherit të zyrës ligjore;
- Përgatit propozimet për përmbardim për procedimin e fëndëve tek përmbarduesit privatë sipas listave me klient borxhli të pranuar nga shërbimi financiar;
- Përgatit përgjigjet për prapësim për kundërshtimet të cilat pranohen nga përmbarduesit privatë;
- Përgatit dhe dorëzon kallëzime penale për personat të cilët kryejnë vepra të kundërligjshme;
- Drafton dhe rishikon rregulloret e brendshme në vazhdimësi s' bashku me grupit punues për draftim të rregulloreve të përcaktuara në eprori linear;
- Kujdeset dhe përcjellë përmbardimin e aktgjyqësive gjerë në përfundimin e çështjes lidhur me aktgjyqësit, aktvendimet (të formës së prerë) me propozim për përmbardim ndaj debitorëve të ndërmarrjes;
- Me likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore në të cilat, ndërmarrja Ambienti paraqitet si kreditor bën kompletimin e kërkesave dhe dorëzimin e tyre në Agjencinë Kosovare të Privatizimit / Fondin Sovran;
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Vepron në kuadër të autorizimit, por është përgjegjës nëse e bënë tejkalimin e autorizimit;
- Kryen punë të tjera që i caktohen nga sekretari dhe eprori linear;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

#### a. Kushtet e përgjithshme :

- Një CV të detajuar
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

#### b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Diplomë Universitare në fushën Juridike;
- Shkathtësi komunikuese dhe aftësi organizative të punës;
- Përvoja e punës së paku 2 (dy) vite e dëshmuar.

### Pozita : Mbledhës i borxheve (Inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë  
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar  
Koeficienti i pagës 1.7

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që në terren të sillt korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A;
- Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthejë në rrillogaritje (korrigjim) tek shefi i faturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat më bllok të vërtetuar nga ndërmarrja;
- Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët;

- Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthejë në rrillogaritje (korrigjim) tek shefi i faturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat më bllok të vërtetuar nga ndërmarrja;
- Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët;
- Në bazë të raportit të lëshuar nga faturistët (Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitike), kontrollon raportin së a janë në përputhje me pagesat në bllokun e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë;
- Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënshkruan mandat arkëtim të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mujor tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Jep përgjegjësi për çdo dëftesë të lëshuar nga blloku i tij me numër serik;
- Jep përgjegjësi për çdo faturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes;
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të shefit të inkasimit dhe faturimit; 32
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja, ku për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

#### a. Kushtet e përgjithshme :

- Një CV të detajuar
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

#### b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit:**Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)

Data e për aplikim është nga 13.11.2024 deri me 28.11.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "AS EVENTS" L.L.C shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810865553.

Valbona Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.

Florent Ajgeraj shpall te pavlefshme 2 dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Agon Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat , diplomën , testin e maturës shtetërore Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Besnik Dacaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm " Mithat Frasheri " Krajk.

- Bedrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale në Prishtinë.

-Teuta Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Blerina Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Qendra Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Fakete Nallbani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Shqiye Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

